RoLE: "The Right to Education and the Rule of Law"

Agjenda

Emri i eventit	Dita ndërkombëtare për eliminimin e dhunës ndaj grave / Seminar Ndërgjegjësues
Vendi	Salla "Charles Crane" Qiriazi University College
Data	25 Nëntor 2026
Ora	09:30-11:15
Project ID	101319919

Time	Rasti studimor / Çështje për diskutim	Participants
9:30-9:45	a. **Prezantimi i aktivitetit. Shifra dhe fakte për dhunën në familje dhe në çift.** Videot e regjistruara me studentët b. **Rasti studimor: Nga Shqipëria në Itali. Historia e një vajze të martuar me mbleséri dhe jeta e saj në çift në emigracion** E.S., e lindur dhe e rritur në një qytet të vogël në veri të Shqipërisë, mbërriti në Itali në vitin 2005, si bashkëshorte e ligjshme e një emigranti shqiptar. Në atë kohë, ajo sapo kishte përfunduar arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe nuk kishte përvojë pune apo kualifikime të veçanta profesionale. Burimi i vetëm i të ardhurave të çiftit ishte paga e bashkëshortit. E.S. nuk e njihte pothuajse fare gjuhën italiane dhe, pas mbërritjes në Itali, nuk kishte mundësi punësimi apo një rrjet mbështetës shoqëror. Për këto arsye, ajo ishte tërësisht e varur ekonomikisht dhe shoqërisht nga bashkëshorti. Pak pas lindjes së djalit fillon dhuna dhe kontrolli. Dhuna është fizike, ndërkohë që kontrolli lidhet me telefonin dhe frikën se mos e denoncon tek autoritetet – nëse më denoncon, nuk e sheh me djalin. Vendos të ikë nga kjo marrëdhënie kur djali është 8 vjeç. Bën denoncim në polici, në këtë kohë në Itali është edhe i vëllai i saj.	**Valbona Nathanaili,** Lektore e Modulit Jean Monnet "RoLE" , Fakulteti i Edukimit, Shkencave Sociale dhe Sporteve
9:45-10:15	***Çështje për diskutim (orientuese):*** **a. Kontrolli dhe dhuna në marrëdhëniet në çift** **b. A mund të flasim për një model pushteti dhe kontrolli?** **c. Terrorizmi intim: të kontrollosh partnerin. Taktika të kontrollit jo të dhunshëm** **d. Çfarë rastesh dhune përfundojnë më shpesh në polici dhe në gjykatë?** Sa ndikon varësia ekonomike në vendimin e një gruaje për të qëndruar në një marrëdhënie të dhunshme? Si bashkëpunojnë shërbimet sociale me policinë, organizatat dhe institucionet e tjera për të garantuar mbështetje të vazhdueshme? Çfarë mund të bëjë konkretisht një organizatë për të ndihmuar një grua që dëshiron të largohet nga marrëdhënia e dhunshme? Në cilën fazë të rastit mund të ndërhyjë ligji, edhe nëse nuk ka pasur ende dhunë fizike?	**Enida Bozheku,** drejtuese e Jean Monnet Module "RoLE", Dekane, Fakulteti i Drejtësisë **Edlira Cepani,** aktiviste për të drejtat e njeriut **Marime Vladi,** Bashkia Kamëz **Orjola Plaku,** Psikologe **Valbona Nathanaili,** Lektore e Modulit Jean Monnet "RoLE" , Fakulteti i Edukimit, Shkencave Sociale dhe Sporteve
10:15-10.45	***Çështje për diskutim (orientuese):*** **a. Rezistenca e dhunshme** **b. Akti i largimit** **c. Sa është koha nga rasti i parë i dhunës deri në denoncimin e saj?** **d. Si ta kuptojmë që një partner ka tendencë për kontroll?** **e. Sa seriozisht merret denoncimi i një gruaje për dhunë nga partneri?** Cilat janë shenjat paralajmëruese që një marrëdhënie po kalon nga konflikti bazuar në një situatë te kontrolli dhe dhuna sistematike? Përse disa gra nuk kërkojnë ndihmë, edhe kur janë të vetëdijshme për rrezikun?	**Haxhire Kasaj,** juriste **Fiona Rushiti,** pedagoge, Mbajtëse e Rekordit Botëror Guinness **Meri Kraja,** Lektore e Modulit Jean Monnet "RoLE" , Fakulteti i Drejtësisë **Edlira Cepani,** aktiviste për të drejtat e njeriut **Valbona Nathanaili,** Lektore e Modulit Jean Monnet "RoLE" , Fakulteti i Edukimit, Shkencave Sociale dhe Sporteve
10:45-11.15	***Çështje për diskutim (orientuese):*** **a. Konfliktet e vogla të zakonshme që shndërrohen në dhunë** **b. Burimet e konflikteve në çift dhe shëndeti mendor e fizik** **c. Marrëdhënia me abuzuesin. A mund të flasim për motiv?** A është dhuna gjithmonë rezultat i humbjes së kontrollit emocional, apo mund të jetë një mjet i qëllimshëm për ushtrimin e pushtetit dhe kontrollit? Si mund të ndërhyjnë familja, profesionistët dhe institucionet pa e ekspozuar viktimën ndaj rreziqeve të mëtejshme?	**Ida Kruti,** zëvendës rektore, psikologe **Arjola Hajdini,** aktiviste e shoqërisë civile **Erjona Fusha,** sociologe, Fakulteti i Ekonomisë **Enida Bozheku,** drejtuese e Jean Monnet Module "RoLE", Dekane, Fakulteti i Drejtësisë **Valbona Nathanaili,** Lektore e Modulit Jean Monnet "RoLE" , Fakulteti i Edukimit, Shkencave Sociale dhe Sporteve

Co-funded by the European Union. Views and opinions expressed are however those of the author(s) only and do not necessarily reflect those of the European Union or the European Education and Culture Executive Agency (EACEA). Neither the European Union nor EACEA can be held responsible for them.